



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agjencia za Razvoj Poloprivrede/Agriculture Development Agency

DIVIZIONI PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN/DIVIZIE ZA JAVNO KOMUNICIRANJE/
/DIVISION OF PUBLIC COMMUNICATION/

THIRRJE PËR APLIKIM

Për Grupet Lokale të Veprimit të përzgjedhura dhe për Rrjetin për Zhvillim Rural të Republikës së Kosovës për përfitim në kuadër të implementimit të “Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020” për Masën 303, nënmasa 303.1 “Përvetësimi i aftësive dhe nxitja/animimi i banorëve të territorit të GLV-ve për GLV-t e përzgjedhura,

1. Qëllimi i thirrjes për aplikim

Është përkrahja e ngritjes së kapaciteteve të GLV-ve të përzgjedhura, anëtarëve të GLV-ve dhe banorëve rural me qëllim të rritjes së shkathtësive të tyre në fushën e demokracisë dhe zhvillimit lokal, si dhe të inkurajimit të tyre në avancimin e nismave dhe partneriteteve lokale. Për më tepër, që të lehtësohet ndërveprimi mes palëve me interes me qëllim të ofrimit të informatave dhe të avancimit të strategjisë e të përkrahjes së përfituesve të mundshëm në zhvillimin e punëve dhe në përgatitjen e aplikacioneve. Po kështu, GLV-të do të jenë në gjendje të kenë strukturë dhe staf të përhershëm.

2. Aplikuesit e pranueshëm

Vetëm Grupet Lokale të Veprimit (GLV -të) të përzgjedhura dhe Rrjeti për Zhvillim Rural (RrZHR) i Republikës së Kosovës për përfitim në kuadër të implementimit të “Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020”

3. Shtrirja gjeografike

Tërë territori i Republikës së Kosovës

4. Aktivitetet e pranueshme

- Përgatitja e studimit për zonën (p.sh.: studime socio-ekonomike, regjionale, të marketingut, etj.);
- Trajnimi dhe shkollimi/edukim i punonjësve dhe anëtarëve të GLV-ve në bazë të temave të ndryshme:
- Temat e ndërlidhura me qasjen LEADER (p.sh.: koncepti LEADER, qeverisja lokale, SZhL, menaxhimi i rrjeteve, avancimi i pjesëmarrjes së palëve me interes, etj.)
- Temat e ndërlidhura me menaxhimin (p.sh.: përgatitja e planeve të biznesit, përgatitja e aplikacioneve për projekte, kontabiliteti dhe raportimi, etj.);
- Tërheqja e interesimit, organizimi i publicitetit dhe materialet e ngjarjet promovuese për anëtarët e GLV-ve dhe banorët e zonës (p.sh. seminare, punëtori, mbledhje, etj.);

Pjesëmarrja e anëtarëve të GLV-ve në seminare, punëtori, mbledhje, vizita studimore, duke përfshirë ngjarjet e organizuara nga Rrjeti për Zhvillim

5. Procedura e aplikimit

Pas kompletimit të dokumenteve të kërkuara, dokumentet e kërkuara për aplikacion dorëzohen në Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë, rruga Luan Haradinaj, ish ndërtesa e bankës së Lubjanës kati i shtatë, Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 10:00 - 12:00 dhe 13:00 - 15:00.

6. Afati për dorëzim të Aplikacionit

Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 15 ditë nga data e publikimit të thirrjes për aplikim në gazetat ditore dhe në web faqet e AZHB-së

Për informata më të hollësishme vizitoni web faqen www.azhb-ks.net, si dhe udhëzuesin për aplikues.

7. Kontaktet dhe pikat (vendet) informuese lidhur me aplikimin

AZHB/MBPZHR

Adresa: (Ndërtesa ish Banka e Lubjanës) Prishtinë

Nga e hëna deri të premten: nga ora 10:00 - 12:00 dhe nga ora 13:00-15:00 tel 038/211-967 ose 038/212-647